REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 247, datë 24.4.2019

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1 dhe 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "C", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida", hiqen individët e renditur në shkronjën "a", sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për persona që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-SË ("LISTA E OKB-së")

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (DA'ESH) DHE AL-QAIDA":

a) Lista e shtuar në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida":

DJAMAT HOUMAT DAAWA SALAFIA (DHDS)

FETHI 2: BEN HASSEN 3: BEN SALEM 4: AL-HADDAD

Shënim: Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

NR.PROT.2194/1
DATË 25/4/.2019

MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT
E JASHTME
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE